

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“OBT Group Ltd” shpk

#### **Neni 1: Data e Themelimit, Emri, Themeluesit dhe forma ligjore**

Sot me **date 24/06/2019**, ne, te nenshkruari:

1. **Stefano Roperti**, lindur ne Soveria Mannelli (CZ), Itali me date 20/05/1985, banues ne Itali, me dokument identifikimi tip pasaporte me Nr.YB0904766;
2. **Antonio Gradilone**, lindur ne Corigliano Calabro (CS), Itali me date 31/01/1987, banues ne Itali, me dokument identifikimi tip pasaporte me Nr.YA6413565, perfaqsuar me prokure nga Stefano Roperti;
3. **Niccolo' Nuvoloni**, lindur ne Badia Polesine (RO), Itali me date 08/10/1990, banues ne Itali, me dokument identifikimi tip pasaporte me Nr.YA2365532;
4. **Roberto Masserut**, lindur ne Pordenone (PN) Itali me date 29/06/1983, banues ne Itali, me dokument identifikimi tip pasaporte me Nr.YA7935531;
5. **Paolo D'ambra**, lindur ne Napoli (NA), Itali me date 13/09/1987, banues ne Itali, me dokument identifikimi tip pasaporte me Nr.YB1780017;
6. **Tristano Mancini**, lindur ne Lanciano(CH), Itali me date 30/09/1979, banues ne Itali, me dokument identifikimi tip pasaporte me Nr.YA4866925

Themelojme *shoqerine me pergjegjesi te kufizuar* me emrin:

“OBT Group Ltd” shpk

#### **Neni 2: Selia**

Selia e shoqerise do te jete: **L.1, Rruga Egnatia, Fly Tower, Kt.4, Durres, Shqiperi .**

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithë territorin Shqipetar dhe jashte saj.

#### **Neni 3: Objekti i aktivitetit**

Shoqeria do te kete per objekt te aktivitetit te saj:

**Trainime dhe kurse te personalizuar on line per perdoruesit potencial te platformave telematike dhe softwareve te specializuara mbi perdorimin e instrumenteve financiar primar dhe derivate ne tregjet financiare nderkombetare; Trainime online per investime ne tituj,**

aksione, obligacione, futures, valute, opsione, dhe te tjere instrumenta finaciar te disponueshem ne tregjet finaciare nderkombetare; Analize ad-hoc i profilit te investitorit potencial, matje dhe analiza te karakteristikave psiko-metrike te tij per te percaktuar perberjen dhe tipin e portofolit te titujve te pershtatshem per te; Teori dhe praktike e asistuar per ndertimin e portofoleve te investimeve dhe investimin ne tregjet finaciare nderkombetare; Kerkim dhe zhvillim i tregjeve te reja per investitorët institucional, broker apo dealer, ne tregjet finaciare globale; Te tjera sherbime te lidhura me ato te permenduara me lart;

Për arritjen e qëllimeve të lartpërmendura, shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e kërkuara, me gjykimin e vetëm të organit administrativ për zbatimin e objektit të shoqërisë.

#### **Neni 4: Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pacaktuar.

## **KREU II**

### **Kapitali i regjistruar**

#### **Neni 5: Vlera e kapitalit të regjistruar**

Kapitali i shoqërisë është 60.000 leke i ndarë në 6(gjashtë) kuota, me vlerë nominale dhe përqindje si më poshtë.

1. **Stefano Roperti:** zoteron 1 (nje) kuota me vlerë 10.002 leke që përben 16,67% të kapitalit themeltar të shoqërisë
2. **Antonio Gradilone:** zoteron 1 (nje) kuota me vlerë 10.002 leke që përben 16,67% të kapitalit themeltar të shoqërisë
3. **Niccolo' Nuvoloni:** zoteron 1 (nje) kuota me vlerë 10.002 leke që përben 16,67% të kapitalit themeltar të shoqërisë
4. **Roberto Masserut:** zoteron 1 (nje) kuota me vlerë 10.002 leke që përben 16,67% të kapitalit themeltar të shoqërisë
5. **Paolo D'ambra:** zoteron 1 (nje) kuota me vlerë 9.996 leke që përben 16,66% të kapitalit themeltar të shoqërisë
6. **Tristano Mancini:** zoteron 1 (nje) kuota me vlerë 9.996 leke që përben 16,66% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/te paluajtshme apo të drejta)



## Neni 6: Trasferimi I kuotave

6.1 Kuotat e shoqerise apo te drejttat qe rrjedhin prej tyre mund te trasferohen nepermjet:

- a) Shitblerjes
- b) Trashigminise
- c) Dhurimit
- d) Cdo memyre tjeter te parashikuar me ligj

### 6.2 Klausola ne lidhje me transferimin e kuotave dhe

a) **Klausola e mostransferimit**

Nuk lejohet transferimi i kuotave gjate 12 muajve te pare te shoqerise me perjashtim te drejtes se heqjes dore nga kuota sipas percaktimeve te ligjit per tegtaret dhe shoqeriter tregtare.

b) **Klausola e preferences se ortakëve ekzistues**

Ne rast tranferimi te kuotave apo te heqjes dore prej saj, ortaku i interesuar, duhet ti komunikojë paraprakisht, me nje nga menytrat qe percaktohen ne ligj dhe ne statut, te gjithë ortakëve te tjere. Komunikimi duhet te permbaje gjeneralitetet e blesesit, kushtet e transaksionit ku minimalisht duhet te jepet informacion mbi cmimin dhe menytrat e pageses apo motivet dhe aryet e operacionit.

Ne keto raste, ortakët e tjere kane te drejten e parablerjes me te njetat kushte sikurse per te tretet te transferimit te kuotave .

Ne rast te ushtrimit te te drejtes se parablerjes nga me shume se nje ortak, kuota dhe perqindja perkatese do te shperndahet midis ortakëve qe kane ushtruar kete te drejte ne proporcion me perqindjet e zoteruara nga secili prej tyre.

c) **Klausola e pelqimit paraprak nga ortakët ekzistues**

Ne rast tranferimi te kuotave, ortaku qe do te transferoje kuotat duhet ti komunikojë paraprakisht, me nje nga menytrat qe percaktohen ne ligj dhe ne statut, te gjithë ortakëve te tjere. Komunikimi duhet te permbaje gjeneralitetet e blesesit, kushtet e transaksionit ku minimalisht duhet te jepet informacion mbi cmimin dhe menytrat e pageses apo motivet dhe aryet e operacionit. Ortakët kane te drejte te bllokojne kete transferim ne rast votimi me maxhiorance te kualifikuar prej 4/5. Ne cdo rast, transferimi nuk quhet I miratuar ne rast se votojne kunder dy ose me shume ortakë te shoqerise

### 6.3 Përjashtimi i ortakut

Duke perfshire parashikimet ligjore, në bazë të një vendimi të kualifikuar me 4/5, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar **shpërblimin e dëmit** të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin në masen e .

Ortakut nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhet në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

### **Neni 7: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Asambleja e përgjithëshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës.

Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga asambleja e përgjithëshme me shumicë të kualifikuar të votave.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblese së Përgjithëshme. Ky vendim merret me shumicë të kualifikuar të votave.

## **KREU III**

### **Organet vendimarrëse dhe drejtuese**

#### **Asambleja e Përgjithëshme e ortakëve**

### **Neni 8: Të drejtat dhe detyrimet**



Asambleja e Përgjithshme e ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë. Konkretisht, Asambleja merr vendime për sa më poshtë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve të administratorëve, likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

#### **Neni 9: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët të pakten dy herë në vit, për të miratuar përkatësisht bilancin vjetor të mbyllur si dhe bilancin vjetor parashikues.

Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Në këtë rast, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Në këtë rast, Asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Në këtë rast, Asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

#### **Neni 10: Menyra e thirrjes**

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të parë të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 11: Thirrja e asamblesë nga ortakët e pakicës**

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me nenin 10 në këtë statut.

Nëse, në kundërshtim me përcaktimin e këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej aksionereve të pakicës nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

### **Neni 12: Përfaqësimi në Asamblenë e Përgjithshme**

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



### Neni 13: Kuorumet dhe marrja e vendimeve

Në rastin e marrjes së vendimeve të zakonshme, që kërkojnë një *shumicë të thjeshtë kualifikuar*, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë *shumicë të kualifikuar*, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me *shumicë të kualifikuar prej pesë të gjashtat (5/6)* e votave të ortakëve pjesëmarrës, për:

- a) ndryshimin e statutit,
- b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
- c) shpërndarjen e fitimeve,
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Për çështjet e tjera të renditura në nenin 8 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Mbledhja e Asamblese drejtohet nga administrator nëse është thirrur prej tij. Nëse Asambleja e Përgjithshme është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesohet nga një nga ortakët e zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje.

Administratori edhe në rastin kur nuk është ortakë i shoqërisë, ka të drejtën e pjesëmarrjes si dhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblese së Përgjithshme.

### Neni 14: Votat e pjesëmarrësve

Çdo kuote i jep ortakut të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar të drejtën e një vote.

Ortakut nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:  
a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Në rast barazimi në vendimet e asamblese, vota e ortakut **Stefano Roperti** ka vlerë të dyfishtë. Kjo e drejtë nuk është e transferueshme tek të tjerët në rast të transferimit të kuotave nga ky ortak.

Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e asamblese se pergjitheshme nese nuk ka shlyer te gjitha detyrimet ne lidhje me kuotat qe ai disponon.

#### **Neni 15: Emërimi I Administratorit**

Administrimi si dhe perfaqsimi I shoqerise I besohen nje apo me shume administratoreve qe mund edhe te mos jene ortake te shoqerise.

Afati maksimal i emerimit te administratoreve eshte 3 vjet me te drejte ripërteritje.

Administrator i pare i shoqerise emerohet **Z.Gazmend Zela (nr.pers: J10924043C)**, me nje mandate 3 vjecar, te cilit i jepen te drejta e percaktuara ne kete statut. Administratorit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqsimit te shoqerise.

Asambleja e Pergjitheshme mund te shkarkoje ne cdo kohe Administratorin nga detyra, me shumice te zakoneshme.

#### **Neni 16: Kompetencat e Administartorit**

Administratori i shoqerise ka te drejte dhe detyrohet:

Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- a) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- b) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë;
- f) të raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjitheshme, ne rastet kur:



- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

### **Neni 17: Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, I ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidale sipas rastit.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- f) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratorët veprojnë nëkundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i

kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- d) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) japin kredi.

Përveç padise për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

#### **Neni 18: Mbledhjet e administratorit**

Administratori kujdeset që në libra të posaçem të mbaje process verbalet e të gjitha takimeve të kryera nga ai, si dhe të gjitha mbledhjet e Asamblese së Përgjithëshme.

### **KREU IV**

#### **Neni 19: Viti Financiar**

Viti financiar fillon me datë 1 Janar dhe mbyllet me datë 31 Dhjetor. Viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në organet përkatëse sipas legjisllacionit në fuqi.

#### **Neni 20 : Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë**

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë në raport me kuotat e zotëruara.



Asambleja e **pergjitheshme** mund te vendose qe fitimi I vitit finaciar ose e nje pjese te tij, te mos I shperndahet **ortakeve** por te perdoret per zmadhimin e kapitalit apo per qellime te tjera te gjykuara te **dobishme** per shoqerine dhe te lejuara nga ligji.

## **KREU V**

### **Prishja – Riorganizimi i shoqerisë**

#### **Neni 21: Prishja dhe likuidimi**

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e pergjitheshme emeron nje likuidator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjitheshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likuidatori shperndan pjesen e mbetur te shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqsojne.

#### **Neni 22: Ftesa për kreditorët**

Likuiduesi duhet te njoftoje kreditorët per te depozituar pretendimet ndaj shoqerise. Shoqeria e publikon kete njoftim sipas percaktimeve te dispozitave ligjore. Pretendimet duhet te depozitohen Brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

#### **Neni 23: Përfundimi I likuidimit**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi njofton organet perkatese dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

#### **Neni 24: Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Per cdo ceshtje e cila nuk gjen percaktim ne nenet e ketij statuti do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo ligji specific ne Republikene Shqiperise

## Neni 25: Mosmarrëveshjet

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin me zbatimin apo interpretimin e normave te ketij statuti, si dhe per mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetetnte Gjykata Shqiptare.

*Ky dokument perbeht nga eshte perpiluar ne dy gjuhe , Shqip dhe italisht dhe neshkruesit deklarojne se jane te vetedishem dhe te njohur me perbajtjen e tij ne cdo nen dhe me vullnetin e tyre te lire e nenshkruajne ne teresi!*

Durres, me date 24/06/2019

### ORTAKET

#### E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

TRISTANO MANCINI  
.....

PAOLO D'AMBRA

.....

STEFANO ROBERTI

.....

NICCOLO NUVOLONI

.....

ROBERTO MASSEI RUT

.....

P. ANTONIO GRADILONE

.....